

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - TRGOVINA I INDUSTRIE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Klasa Orig. Klasa Orig. Klasa Orig.	01	Nr. Prot. Nr. Prot. Nr. Prot.	108 21 04 10
Nr. Dokumenti Nr. Dokumenti Nr. Dokumenti	2		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 33 paragrafi 33.2 të Ligjit Nr.2004/28 Për Punimet nga Metalet e Çmuara, neni 6 paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.02/L-34 Për Metrologji, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/07 Për formën dhe përmbajtjen e shenjave të pastërtisë, mënyrën e përcaktimit dhe shënjimit të shkallës së pastërtisë të punimeve nga metalet e çmuara, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 06/2010

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr. 2008/07 PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJËN E SHENJAVE TË PASTËRTISË, MËNYRËN E PËRCAKTIMIT DHE SHËNJIMIT TË SHKALLËS SË PASTËRTISË TË PUNIMEVE NGA METALET E ÇMURA

Neni 1

Shfuqizohet paragrafi 21.1. i neni 21 të Udhëzimit administrative “Për Formën dhe Përmbajtjen e Shenjave të Pastërtisë, Mënyrën e Përcaktimit dhe Shënjimit të Shkallës së Pastërtisë të Punimeve nga Metalet e Çmuara Nr.2008/07” dhe riformulohet me tekstin si vijon: “Vula e Departamentit të Metrologjisë për vërtetimin e pastërtisë së punimeve nga metalet e çmuara është harta e Republikës së Kosovës, në brendi të së cilës janë inicialet e metalit të çmuar”.

Neni 2
Dispozitat kalimtare

Të gjitha dispozitat tjera të Udhëzim Administrativ “Për Formën dhe Përmbajtjen e Shenjave të Pastërtisë, Mënyrën e Përcaktimit dhe Shënjimit të Shkallës së Pastërtisë të Punimeve nga Metalet e Çmuara Nr.2008/07 të datës 10.06.2010” mbesin në fuqi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 21.04.2010

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU

